



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA POLIÇAN
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot

Poličan me 18.08.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE MJET TEKNOLOGJIK, FADROMË”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- Automjete të rënda 34140000-0
- Automjete të specializuara 34114000-9

VLERA E FONDIT LIMIT: 10 000 000 (dhjetë milion) Monedha LEK

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor BASHKIA POLIÇAN. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit sipas Shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Kërkesat e mësipërme janë detyruese dhe i shërbejnë Autoritetit Kontraktor për të krijuar bindjen e tij se operatorët ekonomik pjesëmarrës ushtrojnë veprimtarinë e tyre konform kërkesave të legjisllacionit në fuqi, përmbushin kriteret ligjore për të marrë pjesë në procedura prokurimi si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet sipas përcaktimeve të legjisllacionit përkatës.

Po ashtu, paraqitja e sigurimit të ofertës është detyrim ligjor i përcaktuar nga legjisllacioni në fuqi, si një mjet garancie për Autoritetin Kontraktor në rast të tërheqjes së ofertës pas afatit përfundimtar për

paraqitjen e ofertave; refuzimit për nënshkrimin e kontratës së prokurimit apo mosparaqitjes së sigurimit të kontratës, kur oferta është shpallur fituese, ose mosplotësimin të ndonjë kushti tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentet e tenderit.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë elektronikisht Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të LPP, pika 1 a dhe 2.

Referuar Ligjit nr. 9573 date 03.07.2006, ndryshuar me Ligjin nr. 106/2018 date 20.12.2018, neni 29 pika 1.

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Kopje të deklaratave të xhiros vjetore të lëshuara nga administrata tatimore përgjatë tre viteve të fundit, 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit që prokurohet

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, pika 1 dhe pika 2 germa a) dhe pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e vlerës është përcaktuar bazuar në nenin 43, pika 2 germa a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b** dhe **3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare**;... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. **Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohej nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.**”

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim që ka paguar taksat dhe tarifatat vendore për kështet e maturuar për vitin 2026 për çdo vënd të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB)

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraesë vërtetimin për taksat dhe tarifatat vendore

Argumenti :Kërkesat e mësipërme bazohen në **nenin 77 pika 1/b dhe 3** të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik¹” në të cilët përcaktohet se, citojmë: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: **b) gjendjen ekonomike dhe financiare;**... 3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. **Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.**”

2.2.3 Kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve 2023, 2024 dhe 2025 të paraqitura në Administratën Tatimore dhe të konfirmuara prej tyre, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve nën 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Në zbatim të nenit 43, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës,

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimin të ngjashëm në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjashtë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës

Kjo do të vërtetohet me dokumentate mëposhtëme:

a)në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik,operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga një ent publik ose faturë tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore ku të jenë shënuar saktë datat,shumat,sasië e mallrave të furnizuara

ose

a) Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat si dëshmi do të pranohen vetëm faturat tatimore shitje, të plotësuar sipas kërkësive të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore ku të jenë shënuar saktë datat,shumat dhe sasië e mallrave të furnizuara

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nenit 40, pika 4, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të disponojë dhe të paraqesë certifikatën e vlefshme:

- **SSH/EN-ISO 9001-2015 ‘Sistemi i menaxhimit të cilësisë’ ose ekuivalente e vlefshme.**

Certifikata e mësipërme duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlersimit të konformitetit i akredituar nga organizimi kombëtar i akreditimit ose organizmi ndërkombëtar akreditues të njohur në Republikën e Shqipërisë

Argumentim: Në bazë të nenit 77 pika 4 të Ligjit Nr 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikës 6, gërma c dhe pikës 8 të nenit të 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe pikës 1 të nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim Prodhuesi ose Autorizim nga Distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallrat (mjetet) objekt prokurimi. Në rast se do të paraqitet Autorizimi nga distributori i autorizuar nga prodhuesi, duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit të autorizuar

Secili nga dokumentat duhet të jetë i vlefshëm nëse është në gjuhë të huaj duhet të jetë i përkthyer në shqip dhe i noterizuar si dhe të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit ose distributorit të autorizuar si : tel,fax,email,ëbsite etje, e nevojshme për AK në rast të verifikimeve

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog/katalogje të prodhuesit ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit ose skede teknike të prodhuesit që përmbajnë të dhëna dhe specifikime teknike të këtyre mallrave objekt prokurimi të cilat duhet të jenë në pëprthje me karakteristikat apo specifikimet teknike të kërkuesit nga AK, për mallin objekt prokurimi

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se me dorëzimin e mjeteve objekti i procedurës së prokurimit (për ato mjete që aplikohen), detyrimisht do të mbulojë me shpenzimet e tij të gjitha pagatat në lidhje me :

- **Tarifën e kontrollit fizik**
- **Tarifën e regjistrimit (targat)**
- **Taksat vjetore**
- **Pagesën për kontrollin teknik (në rastet kur nuk përjashtohet nga DPSHTRR)**
- **Pagesat për TPL**

- Si dhe cdo shpenzim tjetër që lidhet me mjetin (taksa lokale apo të përgjithshme,pronësi etj)

- 1.3.2. Operatori ekonomik duhet të disponoj Licensa me kod VII.3.B ose VII.3.B sipas ligjit nr.9573 datë 03.07.2006 ‘Për autoriparimin,shitblerjen,depozitimin e mjeteve rrugore me motor të rimorkiove dhe pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit ose të braktisura dhe për veprimtari që lidhen me to
- 1.3.3. Operatori ekonomik duhet të marr përsipër me anë të një deklarate se shpenzimet e tij duhet te trajnoje ne nje periudhe prej 2 ditesh drejtuesin e mjetit per perdorimin e fadromes dhe sherbimet e perditeshme si dhe të marr **përsipër me shpenzimet e veta** transportin deri ne objekt të fadromës .

Argumentim: Në bazë të nenit 77 pika 4 te Ligjit Nr 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikës 6, gërma c dhe pikës 8 të nenit të 40, pika 6/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe pikes 1 të nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Hartimi i specifikimeve teknike është kryer nga Bashkia Polican . duke iu referuar kërkesave dhe nevojave të autoritetit kontraktor, referuar kryerjes së shërbimit